



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

Drejtoria	Njësia për të drejta e njeriut dhe barazi gjinore (NJDNJBGJ)
Periudha raportuese	Shkurt 2017
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Premtime Preniqi

#### ***1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues***

Njësia për drejtat e njeriut dhe barazi gjinore (NJDNJBGJ) është mekanizëm për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, standardet ndërkombëtare, politikat, strategjitë dhe planet e veprimeve të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Ecuria e punës së NJDNJBGj është trajtimi i barabartë gjinor, sipas Ligjit për barazi gjinore, mundësi të barabarta sipas Ligjit kundër diskriminimit, masat afirmative, mbi barazinë e mundësive për personat me aftësi të kufizuar, kundër dhunës në familje, mbrojtja e të dhënave personale sipas Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale etj.

Njësia për drejtat e njeriut dhe barazi gjinore (NJDNJBGJ) nuk ka buxhet të ndarë, por aktivitetet i organizon duke bashkëpunuar me drejtori brenda Komunës dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe lokale.

#### ***2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me planprogramin e Komunës për drejtorinë tuaj.***

1. Me organizatën "Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit" (GIZ) edhe gjatë periudhës 2017-2018 do organizojmë aktivitete të ndryshme për grupet e marginalizuara në komunën e Prishtinës, ku dhe kemi bërë planin e punës dhe jemi fokusuar në këto fusha të aktiviteteve:
  - a) Riatdhesimi dhe riintegrimi;
  - b) Mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi me substanca narkotike, dalja në orët e vona;
  - c) Fëmijët në situatë rruge;

d) Qasja e personave më aftësi të kufizuara.

2. Aktivitete e përbashkëta me Grupin e grave, ku një herë në muajt organizojmë mbledhjet e rregullta.
3. Mbledhja e rregullt e Këshillit komunal kundër dhunës në familje, ku gjithashtu jam kryesuese e grupit.
4. Mbledhja e rregullt e Komitetit për personat me aftësi të kufizuara.
5. Në bashkëpunim me “Save the Children” dhe Asamblenë e fëmijëve, do të organizojmë aktivitete të ndryshme me qëllim të përmirësimit të kushteve në fushën e edukimit, shëndetësisë, mbrojtjes, qeverisjes për të drejtat e fëmijëve dhe parandalimin e rreziqeve.

***AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtorja juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë***

1. Si koordinatore e grupit SoRi me organizatën “Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit” (GIZ), edhe gjatë viti 2017 do të organizojmë aktivitete të ndryshme për grupet e marginalizuara në komunën e Prishtinës, duke u bazuar në planin e veprimit, ku dhe kemi filluar me takime për ndarjen e përgjegjësive dhe kompetencave për implementimin e planit me përpikëri;
2. Aktivitete e përbashkëta me Grupin e grave, ku një herë në muaj organizojmë mbledhje të rregullta dhe përgatitim projektpropozimet për aktivitetin e radhës;
3. Mbledhja e rregullt e Këshillit komunal kundër dhunës në familje, ku jam kryesuese e grupit, kemi mbajtur takimin e rregullt të Këshillit koordinues kundër dhunës, ku janë paraqitur të dhënat tremujore dhe janë paraqitur shqetësimet mbi mundësitë e kufizuara të ofrimit të ndihmës;
4. Mbledhja e rregullt e Komitetit për persona me aftësi të kufizuara. Në këtë mbledhje u shqyrtua plani i punës 2017;
5. “Takimi me Save the Children” pas nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit, lidhje me vazhdimin e projekteve për vitin 2017;

6. Takimi me vlerësuesen e projektit të BE “Strengthening Women-led civil society organisations in Kosovo”, Znj. Bistra Netkova, ku implementues ka qenë Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, ku edhe Grupi i grave dhe zyrtarja për barazi gjinore, kanë qen pjesë e aktiviteteve të ndryshme.

**4. *AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.***

1. Me organizatën “Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit” (GIZ), gjatë viti 2017- 2018 do të organizojmë aktivitete të ndryshme për grupet e marginalizuara në komunën e Prishtinës duke u bazuar në planin e veprimit;
2. Aktivitetet e përbashkëta me Grupin e grave, ku një herë në muajt organizojmë mbledhjet e rregullta për të shqyrtuar aktivitetin e radhës;
3. Komiteti për personat me aftësi të kufizuara është themeluar me vendim të Kuvendit dhe mban takime të rregullta.
4. Këshillit komunal kundër dhunës në familje, ku jam kryesuese e grupit, mban takime të rregullta;
5. Aktivitete me “Save the Children”.

***i. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese***

- Njësia për drejtat e njeriut dhe barazi gjinore nuk ka buxhetet.

**4.1.3 *Takimet me palë***

Takime të ndryshme me palë, ku varësisht nga natyra edhe i qasem, duke filluar nga natyra e dhunës në familje, të drejtave të njeriut dhe për mbrojtjen e privatësisë.

**5. *Takimet me institucione të tjera:***

ABGJ, MAPL, ASHMDHP, OSBE, KFOR - italian, "Save the Children", GIZ, USAID, UNDIP, Zyra për qeverisje të mirë, UN-Women, DEMOS, RRGG, HANDIKOS, RESI etj.

## 6. *Diskutime publike / takimet me qytetarë*

### 6.1.1 *Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare*

## 7. *Takime të tjera*

Mbledhjet e organizuara brenda Komunës, si dhe takimet e ndryshme që organizohen si në nivel qendror, ashtu edhe nga OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare, kryesuese e grupit në implementimin e projekteve të financuara nga GIZ, anëtare e grupit për hartimin e rregullores së brendshme komunale për mbrojtjen e të dhënave personale, anëtare e grupit punues për hartimin e Planit lokal të veprimit për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, kryesuese e Grupit komunal për hartimin e planit lokal të veprimit për personat me aftësi të kufizuara etj.

## 8. *SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.*

- Mungesa buxhetore për implementimin e projekteve.

## 9. *REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë, etj.*

## 10. *AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues.*

- Me organizatën "Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit" (GIZ) do organizojmë aktivitete të ndryshme për realizimin e planit;

- Të drejtat e fëmijëve;

- Aktiviteti i përbashkët me Grupin e grave me rastin e 7 marsit Dita e Mësueses/it dhe takimi i përbashkët me Këshillin Bashkiak Tiranë dhe anëtarët e Aleancës së Grave që përfaqësojnë të gjitha forcat politike.

**11. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme**